



Република Северна Македонија
Државен завод за статистика



PROGRAMI PËR HULUMTIME STATISTIKORE 2023-2027

Shkup, shkurt 2023

PËRMBAJTJA

Vendimi i Qeverisë për sjelljen e Programit për hulumtime statistikore, 2023-2027

Lista e shkurtesave

Pjesa e 1: SHËNIME TË PËRGJITHSHME

- 1.1 Baza ligjore për miratimin e Programit të hulumtimeve statistikore
- 1.2 Qëllimi i programit për hulumtime statistikore
- 1.3 Definicionet dhe shpjegimet për nocione të caktuara nga përmbajtja në Program, me udhëzim për plotësim

Pjesa e 2: PROGRAMI PËR HULUMTIME STATISTIKORE, 2023-2027

- 2.1 Hyrje
- 2.2 Përmbajtja e Programit
- 2.3 Bartësit e autorizuar
- 2.4 Misioni, vizioni dhe parimet e statistikës shtetërore
- 2.5 Grumbullimi, përpunimi dhe mbrojtja e të dhënave personale
- 2.6 Detyrat prioritare gjatë periudhës 2023-2027

Pjesa e 3: PJESA NARRATIVE

- 3.1 Hulumtime statistikore
- 3.2 Fushat statistikore sipas Kompediumit statistikor, 2022
 - Statistikat demografike dhe sociale
 - Statistikat ekonomike
 - Statistikat sektoriale
 - Statistikat e mjedisit dhe statistikat shumëdimensionale
 - Metodologjia e grumbullimit, përpunimit, desiminimit dhe analiza e të dhënave

Pjesa e 4: PJESA TABELARE

Në bazë të nenit 20 paragrafit 1 të Ligjit për statistikë shtetërore (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 54/97, 21/07, 51/11, 104/13, 42/14, 192/15, 27/16, 83/18, 220/18 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 31/20), Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut në mbledhjen e mbajtur me 1 shkurt 2023, sjell

PROGRAMI PËR HULUMTIME STATISTIKORE PËR PERIUdhËN 2023-2027

Neni 1

Me këtë program përcaktohen hulumtimet statistikore që do të realizohen në Republikën e Maqedonisë së Veriut në periudhën 2023-2027.

Neni 2

Programi përmban hulumtimet statistikore që do t'i realizoj Enti Shtetëror i Statistikës dhe bartësit e autorizuar.

Në pajtim me këtë Program, në periudhën 2023-2027 do të realizohen hulumtime statistikore të përmendura në pjesën tabelare të këtij Programi.

Lista e shkurtesave

Shkurtesa	Përshkrimi i shkurtesave
ESHS	Enti Shtetëror i Statistikës
BPRMV	Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut
APRMV	Agjencia për punsim i Republikës së Maqedonisë së Veriut
MF-DAP	Ministria e financave – Drejtoria për të Hyrat Publike
MF-DD	Ministria e financave -Drejtoria e Doganave
MPB	Ministria për Punë të Brendshme
MF	Ministria e Financave
MD	Ministria e Drejtësisë
ISHPRMV	Instituti për shëndet publik I Republikës së Maqedonisë së Veriut
ASS	Agjencia për supervizion të sigurimeve
FSSHPRMV	Fondi për sigurim shëndetësor dhe pensional i Republikës së Maqedonisë së Veriut
MBPEU	Ministria e bujqësisë, pylltarisë dhe ekonomisë së ujrave
NVAQ	Numri i vetëm amë i qytetarit
SSE	Sistemi statistikor evropian
PBB	Prodhimi i brendshëm bruto
TIK	Teknologjia informativo-komunikative
KSI	Klasifikimi i sektorëve institucional
KSHPD	Klasifikimi I shpenzimeve personale sipas dedikimit
KPV	Klasifikimi i prodhimeve sipas veprimtarisë
IELLE	Lista e energjencave dhe llojeve të energjisë
MKB-10	Klasifikimi statistikor ndërkombëtar i sëmundjeve dhe problemeve të njejta shëndetësore
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
NOPN	Nomenklatura e objekteve dhe punëve ndërtimore
NPBPGJP	Nomenklatura e prodhimeve bujqësore, prodhimeve pyjore, gjuetia dhe peshkimi dhe shërbimet lidhur me to
KNV	Klasifikimi Nacional sipas Veprimtarisë
KNP	Klasifikimi Nacional sipas Profesioneve
NNPI	Nomenklatura nacionale i prodhimeve industriale
KQJA	Klasifikimi i qëllimeve të institucioneve joprofitabile që u shërbejnë amvisërive
NNJTS	Nomenklatura për njësitë territoriale për statistikë
HSPDT (EDP)	Hulumtime statistike të procedurës për deficit i tepërt
RMV	Republika e Maqedonisë së Veriut
LSH	Lista e shteteve
KSNT	Klasifikimi standard ndërkombëtar tregëtar
HS	Hulumtime statistike

PJESA E 1: SHËNIME TË PËRGJITHSHME

1.1 Baza ligjore për sjelljen e Programit për hulumtime statistikore

Baza ligjore për miratimin e Programit për hulumtime statistikore është neni 20 paragrafi 1 i Ligjit për statistikat shtetërore ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 54/1997, 21/2007, 51/2011, 104/2013, 42/2014, 192 /2015, 27/16, 83/18, 220/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.31/20). Në përputhje me nenin e lartëpërmendur, Programin e sjell Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe publikohet në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut".

Programi është akt nënligjor që përcakton hulumtimet statistikore që kryhen në një periudhë të caktuar kohore dhe përcakton bartësit e autorizuar të cilët, përveç Entit Shtetëror të Statistikave dhe Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut, kryejnë grumbullimin, përpunimin dhe desiminimin e të dhënave statistikore duke zbatuar standardet statistikore, metodat dhe teknikat. Në Programin për hulumtime statistikore përmenden të gjitha hulumtimet statistikore prej të cilave prodhohen të dhënat zyrtare statistikore.

1.2 Qëllimet e Programit për hulumtime statistikore

Programi për hulumtime statistikore 2023-2027 është programi i gjashtë pesëvjeçar i miratuar në Republikën e Maqedonisë së Veriut pas miratimit të Ligjit për statistika shtetërore.

Qëllimi i Programit është:

- Të sigurojë kornizë për prodhimin statistikor, dmth. të përcaktojë hulumtimet statistikore që do të kryhen në periudhën e caktuar pesëvjeçare, me elemente të përcaktuara kryesore të hulumtimeve.
- Të informojë përdoruesit (organet e qeverisjes shtetërore, njësitë e vetëqeverisjes vendore, subjektet afariste, komunitetin shkencor, mediat, institucionet ndërkombëtare dhe publikun e gjerë) për të dhënat që do të prodhohen si të dhëna statistikore zyrtare nga ana e ESHS-së dhe bartësve tjerë të autorizuar.

Programi bazohet në:

- Kërkesat/nevojat e përdoruesve në nivel lokal/kombëtar dhe ndërkombëtar;
- Kërkesat nga strategjitë dhe programet e ndryshme kombëtare/rajonale/ndërkombëtare;
- Kërkesat që dalin nga procesi eurointegruar, si dhe
- Kërkesa nga organizata të ndryshme ndërkombëtare (Kombet e Bashkuara, Banka Botërore, FMN, OECD, etj.).

Të dhënat zyrtare statistikore nga fusha e demografisë, ekonomisë, financave, sferës sociale, bujqësisë dhe mjedisit do të jenë bazë për:

- Marrjen e vendimeve në të gjitha sferat e veprimtarive ekonomike, sociale dhe të tjera nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, ministritë kompetente dhe organet tjera shtetërore në nivel qendror dhe lokal;
- Vendimmarrja nga menaxherët në sektorin privat dhe publik;
- Mbështetja e hulumtimeve shkencore si segment mbështetës i zhvillimit;

- Sigurimi i të dhënave të krahasueshme për zhvillimin e vendit, për shkak të krahasimit me vendet e tjera të rajonit, kandidatët për anëtarësim dhe anëtarët e Bashkimit Evropian, si bazë për përafrimin e Republikës së Maqedonisë së Veriut me Bashkimin Evropian;
- Përafrimi i sistemit statistikor të Republikës së Maqedonisë së Veriut me Sistemin Statistikor Evropian (SSE);
- Vlerësimi i investitorëve të huaj për mundësitë dhe rentabilitetin e investimeve në sferat e interesit të tyre në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

1.3 Definicione dhe shpjegime për nocione të caktuara të përmbajtjeve në Programin, me udhëzim për plotësim

(1-6) Numri i vetëm i hulumtimit statistikor

Definicione / shpjegime

Numri unik i hulumtimit statistikor (HS) në strukturën e tij "X.XX.X.X.XX/XX" përmban: domenin/aktivitetin/fushën/temën/nëntemën/numrin unik të hulumtimit statistikor (HS). Domeni/aktiviteti/fusha dalin nga "Klasifikimi i Veprimtarive Statistike (KVS)/2017". http://www.stat.gov.mk/Nacionalni_Klasifikacii2.aspx?rbr=23
Domeni/aktiviteti/fusha/tema/nëntema del nga "Lista e kodeve standarde të aktiviteteve statistike (SKL_SA)".

Udhëzim për plotësim

Struktura e numrit unik të hulumtimit statistikor është e paracaktuar dhe nuk ndryshon. Nëse hulumtimi tashmë ekziston, pra është shkarkuar/ngarkuar nga Programi i mëparshëm (2018-2023), atëherë nuk plotësohet asgjë. Nëse bëhet fjalë për një hulumtim të ri, për numrin do të kuptohet në bashkëpunim me sektorin e TI-së.

(7) Emri i hulumtimit statistikor

Definicione / shpjegime

Emri i HS paraqet emër të hulumtimit dhe e emërton dukurinë që vijon me hulumtim statistikor, respektivisht në çka referohen të dhënat.

Udhëzim për plotësim

Emri i HS fillon me "Hulumtim statistikor mbi ...". Ky është rasti më i zakonshëm dhe vlen për HS-të që zbatohen në formularë të tillë siç janë raporti, pyetësori, fletë, anketë, dhe ato që nuk zbatohen duke përdorur formularë, dhe si burim i të dhënave paraqiten HS tjera, evidenca, regjistra dhe të ngjajshme. HS-të tjera, kryesisht ato analitike, emërtohen sipas titullit të caktuar (p.sh., Bilanci i pagesave, Llogaritë ekonomike në bujqësi me çmime aktuale, Llogaritë rajonale, etj.).

(8) Qëllimi i hulumtimit statistikor

Udhëzim për plotësim

Në këtë pjesë duhet të përshkruhet qëllimi i hulumtimit statistikor, përkatësisht të përmenden treguesit që prodhohen nga vetë hulumtimi dhe ajo se cilat nevoja të përdoruesve plotësohen nga ai hulumtim. Për shembull: Qëllimi i hulumtimit statistikor për lindjet e foshnjave është të merret numri i lindjeve (lindje të gjalla dhe të vdekura) i cili është element hyrës në përlogaritjen e numrit të popullsisë dhe shtimit natyror. Më pas, numri i popullsisë përdoret si emërues në përlogaritjen e treguesve demografik, shëndetësor dhe ekonomik, si dhe të treguesve të zhvillimit të qëndrueshëm. Numri i popullsisë është një e dhënë bazë në krijimin dhe monitorimin e zbatimit të politikave dhe strategjive qeverisëse në fushat përkatëse.

9) Emri i shkurt i hulumtimit statistikor

Definicione/shpjegime

Emri i shkurt i HS-së paraqet shkurtesën e emrit të HS-së

Udhëzim për plotësim

Shkurtesat e HS janë përcaktuar paraprakisht dhe nuk ndryshohen, respektivisht përdoren shkurtesat nga programi paraprak. Nëse HS është futur rishtazi, shkurtesën ja jep Enti Shtetëror i Statistikës.

(10) Bartës i hulumtimit statistikor

Definicione/ shpjegime

Në bazë të nenit 3 të Ligjit për statistikat shtetërore ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 54/97, 21/07, 51/11, 104/13, 42/14, 192/15, 27/16, 83/18, 220/18 dhe Gazetës Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 31/20), me "bartës të autorizuar" nënkuptohen: Enti Shtetëror i Statistikave, Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe subjektet tjera të përmendura në Programin për Hulumtime Statistike, i cili gjatë grumbullimit, përpunimit dhe shpërndarjes së të dhënave zbaton standardet, metodat dhe teknikat statistike.

Sipas nenit 6, bartësit e autorizuar kryejnë këto detyra:

- përgatit bazat metodologjike për hulumtimin statistikor;
- përgatit instrumentet për realizimin e hulumtimit (metodologjitë, udhëzimet, formularët dhe të tjera);
- kryejë përpunimin dhe shpërndarjen e të dhënave zyrtare statistike të marra nga hulumtimet statistike dhe
- kryen punë të tjera të përcaktuara me këtë ligj.

Udhëzim për plotësim

Shkruhet/zgjedhet emri i institucionit që është përgjegjës për hulumtimin statistikor përkatës (p.sh., Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Punëve të Brendshme, Instituti i Shëndetit Publik i Republikës së Maqedonisë së Veriut, etj.).

(11) Periodika e zbatimit të hulumtimit statistikor

Definicione/shpjegime

Periodika e hulumtimit statistikor paraqet kornizë kohore në të cilën zbatohet HS-ja. Periodika e zbatimit të HS-së mund të jetë:

- Javore
- Mujore
- Tremujore
- Gjashtëmujore
- Vjetore
- Dyvjeçare
- Trevjeçare
- Katërvjeçare
- Pesëvjeçare
- Dhjetëvjeçare

Udhëzim për plotësim

Shkruhet / zgjedhet periodika e cila është përkatëse për atë hulumtim.

(12) Njësitë raportuese

Definicione/shpjegime

Në përputhje me Ligjin për statistikat shtetërore, njësi raportuese janë personat juridikë, personat fizikë, organet e qeverisjes shtetërore, ekonomitë familjare, të cilat në kuadër të HS-së ofrojnë të dhëna për qëllime statistikore. Përveç të lartëpërmendurve, si burim të dhënash mund të përdoren edhe të dhënat administrative, regjistrat, hulumtimet e tjera statistikore etj.

Udhëzim për plotësim

Shkruhet emri i njësisë raportuese e cila është përkatëse për atë hulumtim.

(13) Të dhënat që grumbullohen me hulumtimin (përmbajtja e shkurtër e hulumtimit statistikor)

Udhëzim për plotësim

Në këtë pjesë duhet të përmenden të dhënat të cilat grumbullohen me hulumtime statistikore (të dhëna hyrëse në përpunimin statistikor).

(14) Metoda e grumbullimit të të dhënave

Definicione/shpjegime

Metoda e grumbullimit të të dhënave është një pjesë e rëndësishme e hulumtimit statistikor. Zgjedhja e metodës së grumbullimit të të dhënave varet nga vetë lloji i fenomenit, burimet e të dhënave dhe mjetet që janë në dispozicion të institucionit që i grumbullon ato të dhëna.

Në thelb, metodat e mëposhtme rekomandohen në praktikën statistikore:

- Përfshirja e plotë (regjistrimi): Regjistrimi është hulumtim i cili realizohet me përfshirjen e të gjitha njësive që i përkasin grupit të caktuar të vëzhgimit ose hulumtimit. Të gjitha hulumtimet që kanë përfshirje të plotë të njësive quhet regjistrim.
- Mostër: Mostra paraqet një pjesë (ekstrakt) më të vogël të njësive statistikore nga një grup më i madh i njësive. Është nëngrup i njësive që posedojnë të njëjtat karakteristika sikurse grupi. Në statistikë, mostra përdoret kur popullata (dukuria) që matet është e madhe dhe nuk është e mundur të përfshihen të gjitha njësitë në hulumtim. Mostra duhet të jetë përfaqësuese.
- Administrative – metoda e grumbullimit administrativ paraqet përdorimin e burimeve/bazave administrative që ekzistojnë në institucione të tjera, në mënyrë të formalizuar më parë përmes memorandumeve ose marrëveshjeve të shkëmbimit të të dhënave.
- E kombinuar - kjo metodë nënkupton grumbullimin e të dhënave për të njëjtin hulumtim me dy metoda, për shembull, nëpërmjet një ankete dhe në rrugë administrative.
- Analitike – kjo paraqet një mënyrë të brendshme të përdorimit/llogaritjes së të dhënave të grumbulluara tashmë nga hulumtimet e tjera për qëllime analitike.

Udhëzim për plotësim

Shkruhet/zgjedhet emri i metodës e cila është përkatëse për atë hulumtim.

(15) Mënyra e grumbullimit të të dhënave

Definicione/shpjegime

Mënyra e grumbullimit të të dhënave i referohet aspekteve teknike të grumbullimit të të dhënave që aplikohen nga institucionet që kryejnë hulumtime statistikore. Mënyra e grumbullimit të të dhënave përmban elementet e "Kodit të punës të statistikave evropiane" në lidhje me përpjekjet e institucioneve për të ulur ngarkesën e njësive raportuese dhe parimin e efikasitetit dhe

racionalitetit. Vendimi për mënyrën e grumbullimit të të dhënave gjithashtu lidhet edhe me çështje financiare dhe organizative shtesë në lidhje me informimin e njësive raportuese për mënyrën dhe kohën e grumbullimit të të dhënave, si dhe ndërmarrjen e masave për mbrojtjen e të dhënave.

Metodat e grumbullimit të të dhënave mund të jenë:

**Intervistë me pyetje / Intervistë personale* - intervistën/anketën e bën nga një intervistues, duke plotësuar një pyetësor në letër ose duke futur të dhënat në laptop (CAPI-Computer Assisted Personal Interview);

- *Intervistë me kompjuter ose intervistë telefonike* (CATI-Computer Assisted Telephone Interview) - intervistuesi grumbullon të dhënat përmes telefonit dhe i fut ato në një aplikacion kompjuterik
- *Vetëplotësimi* - pyetësor në letër - njësia raportuese plotëson vetë një pyetësor në letër
- *Vetëplotësimi* - pyetësor në internet/elektronik - vetë njësia raportuese plotëson një pyetësor elektronik të postuar në faqen e internetit të ESHS-së (CAWI-Computer Assisted Web Interview);
- *Vetëplotësimi* - të dhënat në formë elektronike - nënkupton plotësimin e pyetësorit elektronik përmes sistemit e-Stat (njësia raportuese e plotëson pyetësorin vetë përmes sistemit e-Stat, me anë të fjalëkalimeve të marra më parë);
- *Vëzhgimi* - të dhënat grumbullohen nga persona-vlerësues ose regjistruar të autorizuar për hulumtim;
- *Mënyra administrative* - mënyra e shkarkimit të të dhënave nga burimet administrative, në varësi të kushteve të përcaktuara në marrëveshjet formale për shkëmbimin e të dhënave;
- *Metoda e kombinuar* - kjo metodë përdoret ekskluzivisht në fushën e llogarive kombëtare.

Udhëzim për plotësim

Shkruhet emri i mënyrës së grumbullimit i cili është përkatës për atë hulumtim.

(16) Viti i zbatimit të hulumtimit statistikor

Definicione/shpjegime

Viti i zbatimit të HS-së është viti në të cilin realizohet HS-ja, edhe atë:

- 2023
- 2024
- 2025
- 2026
- 2027

Udhëzim për plotësim

Shënohet viti në të cilin do të kryhet hulumtimi përkatës.

(17) Niveli territorial i publikimit

Definicione/Shpjegime

Paraqitja e të dhënave statistikore kryhet në një formë në të cilën tregohen vëllimi, struktura, përmbajtja dhe karakteristikat e tjera të dukurisë së studiuar. Një nga karakteristikat është

paraqitja e dukurisë së studiuar në një nivel të caktuar territorial, i cili kryhet në përputhje me "Nomenklaturën e Njësive Territoriale për Statistikat - NTES" (2014), përkatësisht:

- NTES 1 dhe 2 (Republika e Maqedonisë)
- NTES 3 (rajonet statistikore)
- NTES 4 (komunat)
- NTES 5 (vendbanimet)

Udhëzim për plotësim

Shënohet niveli territorial në të cilin do të publikohen të dhënat nga hulumtimi përkatës.

(18) Afati i publikimit (T + ditë)

Definicione/Shpjegime

Afati i publikimit është periudhë kohore që paraqet periudhë të shprehur në ditë nga periudha e referencës deri në datën e publikimit të të dhënave.

Afati tregohet me T+ditë, ku "T" tregon periudhën e referencës (ditën e fundit të periudhës së referencës), plus numrin e ditëve ndërmjet fundit të periudhës së referencës dhe publikimit.

Afati i publikimit i referohet afatit të parë të publikimit të të dhënave.

Një periudhë referimi është një periudhë kohore për të cilën grumbullohen të dhënat ose llogariten rezultatet. Periudha e referencës mund të jetë një vit kalendarik (viti referues), viti fiskal, tremujori, semestri, muaji apo edhe një ditë.

Udhëzim për plotësim

Shkruhet afati i shprehur si ditë T+, në varësi të hulumtimit.

(19) Viti i auditimit

Definicione/Shpjegime

Auditimi paraqitet si pasojë e balancimit të dy dimensioneve shumë të rëndësishme të cilësisë: realizimi në kohë dhe saktësia. Për të ruajtur afatet kohore të një produkti të duhur të të dhënave statistikore (si një nga dimensionet më të rëndësishme të cilësisë), të dhënat statistikore publikohen brenda afateve të paracaktuara, për të cilat analiza shitesë duhet të bëhen më vonë dhe të njejtat të rishikohen (korrigjohen). Përveç kësaj, futja e përmirësimeve metodologjike dhe përmirësimi i standardeve statistikore shpeshherë nënkuptojnë ndryshime të rëndësishme që kanë ndikim në të dhënat e publikuara më parë, gjë që rezulton edhe në nevojën për auditim. Auditimi i referohet rishikimit të të dhënave statistikore tashmë të publikuara dhe rezulton në të dhëna të reja për të kaluarën të cilat janë pasojë e:

- ndryshimeve konceptuale (p.sh. ndryshimet në nomenklaturë dhe definicione),
- përmirësimi i algoritmeve në lidhje me procedurat metodologjike,
- ndryshimet në burimet e të dhënave statistikore.

Auditimi i planifikuar paraqitet në baza vjetore, edhe atë:

- 2023
- 2024
- 2025
- 2026
- 2027

Udhëzim për plotësim

Shënohet viti në të cilin do të kryhet auditimi i të dhënave.

(20) Legjislacioni i BE-së

Definicione/Shpjegime

Sistemi statistikor i vendit është në një proces të vazhdueshëm të harmonizimit të statistikave të vendit me standartet evropiane nëpërmjet aplikimit të rregulloreve evropiane. Legjislacionin e BE- së mund ta gjeni në: <http://www.eurlex.com/>

Udhëzim për plotësim

Përmenden të gjitha rregulloret me të cilat është e lidhur hulumtimi përkatës.

(21) Standartet ndërkombëtare

Definicione/Shpjegime

Për t'i harmonizuar statistikat në vend me rekomandimet e BE-së, përveç rregulloreve të BE-së, përdoren dokumente të tjera në formë të metodologjive, rekomandimeve, udhëzimeve, manualeve etj., gjë që siguron një qasje unike në grumbullimin, klasifikimin dhe prezantimin e të dhënave statistikore si dhe krahasueshmërinë e tyre me të dhënat statistikore të vendeve anëtare të BE-së. Si standarde ndërkombëtare konsiderohen edhe manualët të rekomanduara nga organizatat ndërkombëtare.

Udhëzim për plotësim

Përmenden të gjitha standartet me të cilat është i lidhur hulumtimi përkatës.

PJESA 2: PROGRAMI PËR HULUMTIME STATISTIKORE 2023-2027

2.1 Hyrje

Programi për hulumtime statistikore është një dokument në të cilin Enti Shtetëror i Statistikës dhe bartësit e tjerë të hulumtimit statistikor i konceptojnë hulumtimet që sigurohen treguesit më të rëndësishëm, respektivisht të dhëna nga fusha që e mbulojnë. Këto të dhëna, në përgjithësi, prodhohen

në bazë të kritereve kryesore të hulumtimeve statistikore nga të cilat merren të dhënat zyrtare bazuar në përfshirjen adekuate, përcaktimin e dukurisë dhe njësive, përcaktimin e nivelit territorial të grumbulluar dhe publikimin e të dhënave, veçanarisht është e rëndësishme niveli i mbrojtjes së të dhënave.

Në programin janë të përmbajtura hulumtime me të cilat realizohen drejtimet më të rëndësishme për harmonizimin e statistikave në vend me rregulloret dhe standardet ndërkombëtare për të siguruar të dhëna të krahasueshme ndërkombëtarisht, por edhe hulumtime që ofrojnë më shumë tregues për nevojat e përdoruesve në vend.

Koncepti bazë i Programit është dizajnuar në përputhje me parimet e "Kodit të punës për statistikat evropiane" të Eurostat-it dhe parimet e statistikave shtetërore, për përdorimin e standardeve unike për hulumtimet statistikore të të gjithë pjesëmarrësve në Program dhe shmangien e ngarkesës së tepërt të njësive raportuese.

2.2 Përmbajtja e Programit

Programi i hulumtimit statistikor 2023-2027 përbëhet nga pjesa narrative dhe tabelare ndërsa HS-të janë paraqitur sipas numrit unik të HS-ve, të strukturuar sipas "Klasifikimit statistikor të aktiviteteve" dhe "Listës standarte koduese të aktiviteteve statistikore".

Në pjesën narrative, informacioni për HS grupohet sipas fushave me shfaqje të përmbajtjes brenda çdo fushe sipas aktiviteteve/fushave/temave/nëntemave.

Programi për hulumtime statistikore 2023-2027, në pjesën tabelare përmban këto të dhëna dhe shpjegime për përmbajtjen e atyre të dhënave, edhe atë:

- (1-6) Numri unik i hulumtimit statistikor
- (7) Emri i hulumtimit statistikor
- (8) Qëllmi i hulumtimit statistikor
- (9) Emri i shkurtër i hulumtimit statistikor
- (10) Bartës
- (11) Periodiciteti i zbatimit të hulumtimit statistikor
- (12) Njësiti raportuese
- (13) Përmbajtja e shkurtër e hulumtimit statistikor
- (14) Metoda e grumbullimit të të dhënave
- (15) Mënyra e grumbullimit të të dhënave
- (16) Viti i zbatimit të hulumtimit statistikor
- (17) Niveli territorial i publikimit
- (18) Afati i publikimit (T + ditë)
- (19) Viti i auditimit
- (20) Legjislacioni i BE-së
- (21) Standartet ndërkombëtare

Në varësi të kushteve për realizimin e planeve për avancimin e hulumtimit statistikor, ky Program mund të plotësohet me informacione për hulumtime të reja statistikore ose me ndryshime në ato ekzistuese, në baza vjetore.

2.3 Bartësit e autorizuar

Sistemi kombëtar statistikor, përveç Entit Shtetëror të Statistikës, përbëhet edhe nga organe të tjera të autorizuar që do të bëjnë hulumtime statistikore në periudhën 2023-2027 dhe janë në kornizat të statistikave shtetërore të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Këto janë:

- Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut
- Ministria e Financave
- Ministria e Punëve të Brendshme
- Ministria e Drejtësisë/Këshilli Gjyqësor
- Agjencia për Punësim e Republikës së Maqedonisë së Veriut
- Instituti për shëndet publik i Republikës së Maqedonisë së Veriut

2.4 Misioni, vizioni dhe parimet e statistikave shtetërore

Misioni i statistikave shtetërore është të prodhojë dhe të shpërndajë të dhëna zyrtare statistikore për ekonominë dhe shoqërinë në Maqedoni, si bazë për procesin e vendimmarrjes, bazuar në informacionin përkatës. Publikimi i informacionet statistikore duhet të jenë i cilësisë së mirë, në kohë, i paanshëm, i aksesueshëm dhe i lehtë për t'u përdorur.

Vizioni i statistikës shtetërore është të sigurojë të dhëna statistikore cilësore, në kohë dhe të krahasueshme ndërkombëtarisht.

Statistika shtetërore bazohet në 15 parimet e dhëna në "Kodeksin e punës për statistikat evropiane" të cilat i referohen të gjithë bartësve të autorizuar:

1. Pavarësia profesionale
2. Mandati për grumbullimin e të dhënave
3. Përshtatshmëria e burimeve
4. Përkushtimi ndaj cilësisë
5. Besueshmëria statistikore
6. Paanshmëria dhe objektiviteti
7. Metodologjia profesionale
8. Procedurat statistikore të përshtatshme
9. Ngarkesë e moderuar për ofruesit
10. Efektiviteti i shpenzimeve
11. Rëndësia
12. Saktësia dhe besueshmëria
13. Realizimi në kohë dhe brenda afateve të përcaktuara (rregullsia)
14. Koherenca dhe krahasueshmëria
15. Disponueshmëria dhe qartësia.

2.5 Grumbullimi, përpunimi dhe mbrojtja e të dhënave personale

Me hulumtimin statistikor të përmendur në Programin për hulumtime statistikore, grumbullohen një sasi e madhe e informacionit të nevojshëm për prodhimin e të dhënave statistikore. Lidhur me parimin

e konfidencialitetit statistikor nga “Kodi i punës së statistikave evropiane”, i kushtohet vëmendje e veçantë të dhënave personale të grumbulluara nga njësitë raportuese.

Metoda e grumbullimit të të dhënave personale është administrative, por përdoret edhe metoda e grumbullimit të drejtpërdrejtë të të dhënave përmes formularëve statistikorë të përgatitur nga Enti Shtetëror i Statistikës.

Sipas Programit të hulumtimeve statistikore, të dhënat personale grumbullohen në statistikat demografike, sociale dhe ekonomike.

Në hulumtimet e caktuara statistikore grumbullohen edhe kategori të veçanta të të dhënave personale, e mbi të gjitha të dhëna për përkatësinë etnike të personave fizik. Nevoja për grumbullimin e këtyre të dhënave buron nga obligimet e përcaktuara në Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë së Veriut, si dhe në një numër më të madh ligjesh nga këndvështrimi i përfaqësimit të drejtë dhe të balancuar të pjesëtarëve të bashkësive etnike në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Në hulumtimet statistikore grumbullohen të dhëna edhe për numrin e vetëm të identifikimit të qytetarit. Nevoja për grumbullimin e numrit amë të identitetit buron nga nevoja për të siguruar të dhëna personale përkatëse dhe relevante dhe përgatitja e statistikave relevante, cilësore dhe të krahasueshme ndërkombëtarisht. Në realizimin e qëllimit të përmendur, numri amë i identitetit përdoret në fazën e grumbullimit të kategorive të veçanta të të dhënave personale dhe në kontrollin e të dhënave të grumbulluara, pas së cilës kryhet ndarja nga variablat, gjë që është në përputhje me “Ligji për statistikat shtetërore”.

Në funksion të mbrojtjes së të dhënave personale, Enti Shtetëror i Statistikës ka krijuar një sistem për masat teknike dhe organizative për të siguruar konfidencialitetin dhe mbrojtjen e përpunimit të të dhënave personale.

Në të njëjtën kohë, të dhënat e grumbulluara përmes hulumtimeve statistikore janë të dhëna konfidenciale, që do të thotë se ato mund të përdoren vetëm për qëllime statistikore dhe se përdorimi i tyre për qëllime tjera është i ndaluar, si dhe zbulimi i paligjshëm i tyre.

2.6 Detyrat prioritare në periudhën 2023-2027

Detyrat prioritare të Entit Shtetëror të Statistikës dhe bartësve të tjerë të autorizuar të hulumtimeve statistikore përmbahen në dokumentet strategjike të institucioneve për harmonizimin e statistikave në përputhje me rekomandimet ndërkombëtare dhe në përputhje me detyrimet për të siguruar informacionin përkatës për të mbështetur strategjitë zhvillimore të vendit, respektivisht për nevojat e komunitetit afarist.

Në periudhën e ardhshme pesëvjeçare, Enti Shtetëror i Statistikës dhe bartësit e tjerë të autorizuar të hulumtimit statistikor në procesin e harmonizimit të statistikave me standartet statistikore evropiane dhe ndërkombëtare do t'i:

- avancojnë dhe racionalizojnë hulumtimet statistikore;
- përmirësojnë cilësinë në proceset dhe produktet statistikore;
- modernizojnë metodat e grumbullimit dhe llogaritjes së të dhënave;
- zvogëlojnë shpenzimet për prodhimin e informacionit statistikor;
- zvogëlojnë ngarkesën mbi njësitë raportuese (me aplikimin e metodave të reja të grumbullimit të të dhënave statistikore përmes përdorimit më të madh të të dhënave administrative);
- të prodhojnë statistika zyrtare që do të plotësojnë më mirë nevojat e përdoruesve;
- të prodhojnë një numër në rritje treguesish që do të përdoren për monitorimin e planeve strategjike të qeverisë.

Enti Shtetëror i Statistikës në periudhën e ardhshme pesëvjeçare do të kryej Regjistrimin e bujqësisë.

Duhet theksuar se ky Program duhet të zbatohet në një periudhë kur vendi është duke zhvilluar negociata për anëtarësim në Bashkimin Evropian. Në përputhje me metodologjinë e re të negociatave, Kapitulli 18 - Statistikat përfshihet në grupin e parë dhe duhet t'u përgjigjet nevojave të harmonizimit si në fushën e statistikave ashtu edhe në fushën e mbështetjes për të gjithë kapitujt e tjerë, duke shpërndarë të dhënat e nevojshme për procesin e negociatave.

Kushti kryesor për realizimin e këtij Programi është mbështetja e vazhdueshme financiare e Entit Shtetëror të Statistikës, si dhe rritja e vazhdueshme e kapaciteteve njerëzore, që është rekomandim bazë në të gjitha raportet e Komisionit Evropian për progresin e Republikës së Maqedonisë së Veriut. Nëse nuk parashikohen mjetet e nevojshme në buxhetet vjetore për hulumtime statistikore për periudhën 2023-2027, ekziston rreziku që një pjesë e Programit të mos zbatohet, gjë që do të ngadalësonte procesin e harmonizimit me Sistemin Statistikor Evropian (ESS), dhe në të njëjtën kohë do të vihej në pikëpyetje sigurimi i informacioneve përkatëse për të mbështetur strategjitë e zhvillimit të vendit, respektivisht për nevojat e komunitetit afarist.

PJESA 3: PJESA NARRATIVE

3.1 Hulumtimi statistikor

Hulumtimi statistikor paraqet studimin e karakteristikave të popullatës së veçantë duke grumbulluar të dhëna nga e gjithë popullata ose nga një mostër e asaj popullate dhe duke i notuar/vlerësuar karakteristikat përmes përdorimit të metodologjisë statistikore.

Termi hulumtim statistikor përfshin çdo aktivitet që grumbullon ose pajiset me të dhëna statistikore. Kjo përfshin regjistrimet, hulumtimet mostër, grumbullimin e të dhënave nga të dhënat administrative që rrjedhin nga aktivitete të tjera statistikore.

Në këtë program janë paraqitur ekskluzivisht hulumtimet statistikore. Në Programin e hulumtimeve statistikore 2023-2027 janë paraparë gjithsej 279 hulumtime. Duhet theksuar se Programi nuk përmban statistika multi-domene që janë produkt i disa hulumtimeve statistikore dhe nga disa sektorë të Entit, si statistikave gjinore, treguesit e zhvillimit të qëndrueshëm, treguesit bazë ekonomike evropiane, cilësia e jetës, përgatitja /përditësimi i klasifikimeve dhe nomenklaturave etj.

Tabela 1: Hulumtimet statistikore, sipas bartësve

	Gjithsej
Gjithsej	280
Enti Shtetëror i Statistikës	228
Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut	28
Ministria e Financave	3
Ministria e Punëve të Brendshme	6
Ministria e Drejtësisë / Këshilli Gjyqësor	3
Instituti për Shëndet Publik i Republikës së Maqedonisë së Veriut	8
Agjencia e Punësimit në Republikës së Maqedonisë	4

Tabela 2: Hulumentimet statistikore sipas bartësve dhe numri i hulumtimeve sipas vitit të zbatimit

	Gjithsej	Sipas vitit të zbatimit				
		2023	2024	2025	2026	2027
Gjithsej	280	266	262	270	265	266
Enti shtetëror i statistikës	228	216	210	218	213	214
Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut	28	28	28	28	28	28
Ministria e Financave	3	3	3	3	3	3
Ministria e Punëve të Brendshme	6	6	6	6	6	6
Ministria e drejtësisë / Këshilli Gjyqësor	3	3	3	3	3	3
Instituti për Shëndet Publik i Republikës së Maqedonisë së Veriut	8	6	8	8	8	8
Agjencia e Punësimit në Republikës së Maqedonisë	4	4	4	4	4	4

Tabela 3: Hulumentimet statistikore sipas bartësve dhe periudhës së zbatimit

	Gjithsej	Sipas vitit të zbatimit							
		mujore	tremujor (tremujor)	Gjashtëmujor (gjysëmvetor)	vjetore	dy vjeçare	tre vjeçare	katër vjeçare	pesë vjeçare
Gjithsej	280	44	45	5	167	3	7	2	5
Enti Shtetëror i Statistikës	228	31	27	2	149	3	7	2	5
Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut	28	9	16	3					
Ministria e Financave	3	1	2						
Ministria e Punëve të Brendshme	6				6				
Ministria e Drejtësisë / Këshilli Gjyqësor	3				3				
Instituti për Shëndet Publik i Republikës së Maqedonisë së Veriut	8				8				
Agjencia e Punësimit i Republikës së Maqedonisë	4	3			1				

3.2 Fushat statistikore sipas Kompediumit statistikor, 2022

Në përputhje me Kompediumin statistikor të Eurostat, 2022, të gjitha hulumentimet statistikore ndahen në 5 fusha, edhe atë:

Statistikat demografike dhe sociale
Statistikat ekonomike
Statistikat sektoriale
Statistikat e mjedisit dhe multi-domene
Metodologjia e grumbullimit, përpunimit, shpërndarjes dhe analizës së të dhënave

Statistikat demografike dhe sociale

Statistikat demografike dhe sociale ndjekin lëvizjet demografike dhe sociale në vend dhe përfaqësojnë sistem statistikor matës që studion sjelljen e njeriut në një mjedis social. Mjedisi social monitorohet dhe analizohet nëpërmjet statistikave të sistemuara në fushat e mëposhtme:

- Popullsia dhe migrimet
- Forca e punës
- Arsimi
- Mbrojtja shëndetësore
- Të ardhurat dhe konsumi
- Mbrojtja sociale
- Drejtësia dhe krimi
- Kultura

Popullsia dhe migrimet – i përfshin temat: regjistrimi i popullsisë dhe ekonomive familjare, statistikën vitale - lindjet dhe vdekjet, martesat dhe divorcet, migrimet, azili, vlerësimet e popullsisë.

Fuqia punëtore – i përfshin temat: punësimi dhe papunësia, të ardhurat dhe kostot e fuqisë punëtore.

Arsimi – i përfshin temat: arsimi fillor, arsimi i mesëm, arsimi i lartë, aftësimi profesional dhe mësimi i përjetshëm.

Kujdesi shëndetësor – i përfshin temat: shëndeti publik, shëndeti dhe siguria në punë, faturat shëndetësore.

Të ardhurat dhe konsumi – i përfshin temat: konsumi familjar, të ardhurat, varfëria dhe kushtet e jetesës, cilësia e jetës.

Mbrojtja sociale – i përfshin temat: mbrojtja sociale dhe mbrojtja e fëmijëve.

Drejtësia dhe krimi – i përfshin temat: drejtësia dhe krimi dhe dhuna me bazë gjinore.

Kultura – i përfshin temat: kulturë, informim publik.

Statistikat ekonomike

Statistikat ekonomike sigurojnë të dhëna për ekonominë e vendit dhe përfshin aktivitetet/fushat e mëposhtme:

- Statistikat makroekonomike
- Financat qeveritare, fiskale dhe statistikat e sektorit publik
- Llogaritë ekonomike
- Statistikat afariste
- Tregtia ndërkombëtare dhe bilanci i pagesave
- Çmimet

Statistikat makroekonomike – i përfshijnë temat: magazinimi i të dhënave të llogarive kombëtare, llogaritë kombëtare, agregatat (vjetore, tremujore), tendencat afariste, treguesit ekonomikë.

Financat qeveritare, fiskale dhe statistikat e sektorit publik – i përfshin temat: të hyrat dhe shpenzimet buxhetore, borxhi publik.

Llogaritë ekonomike – i përfshin temat: llogaritë kombëtare (vjetore), tabelat e ofertave dhe përdorimit, tabelat input-output.

Statistikat afariste – i përfshin temat: statistikat strukturore afariste (shërbimet, industria, tregtia distributive, ndërtimtaria, shërbimet afariste), demografia afariste, statistikat afatshkurtra afariste (industria, ndërtimtaria, tregtia e brendshme, shërbimet), regjistri statistikor afarist.

Tregtia ndërkombëtare dhe bilanci i pagesave - përfshin temat: tregtia ndërkombëtare e mallrave, tregtia ndërkombëtare e shërbimeve, investimet e huaja direkte, bilanci i pagesave.

Çmimet - përfshin temat: çmimet në bujqësi, çmimet e produkteve industriale, çmimet e energjisë, çmimet në ndërtimtarë, çmimet në turizëm dhe hotelieri, çmimet e shërbimeve, çmimet e shitjes me pakicë dhe kostoja e jetesës, paritetet e fuqisë blerëse.

Statistikat sektoriale

Statistikat sektoriale përfshijnë aktivitetet/fushat e mëposhtme:

- Bujqësi, pylltari, peshkim
- Energji
- Transport
- Turizëm
- Shkencë, teknologji dhe inovacion

Bujqësia, pylltaria, peshkimi - përfshin temat: bujqësia (prodhimi bimor, blegtoaria dhe produktet blegtorale, qumështi dhe produktet e qumështit, struktura e ekonomive bujqësore, llogaritë bujqësore, gjuetia, prodhimi organik), pylltaria, peshkimi, regjistri statistikor i ekonomive bujqësore.

Energjia - përfshin temat: energjia (vjetore, mujore dhe afatshkurte), bilanci energjetike.

Transporti - përfshin temat: transporti (rrugor, hekurudhor, liqenor, ajror).

Turizmi - përfshin temat: turizëm, hotelieri

Shkenca, teknologjia dhe inovacioni – i përfshin temat: hulumtim dhe zhvillim, inovacion.

Statistikat e mjedisit jetësor dhe multi-domaine

Statistikat e mjedisit jetësor dhe atyre multi-domaine përfshijnë aktivitetet/fushat e mëposhtme:

- Mjedisi jetësor
- Informacion statistikor rajonal dhe hapësinore
- Treguesit e zhvillimit të qëndrueshëm

Mjedisi jetësor - përfshin temat: mjedisi jetësor (mbeturinat dhe substancat e rrezikshme, uji), llogaritë fizike të mjedisit jetësor (rrjedhat e materialeve), llogaritë monetare të mjedisit jetësor (kostot, taksat).

Informacioni statistikor rajonal dhe hapësinore - mbulon temat: statistikat rajonale dhe menaxhimi i klasifikimit NTES.

Treguesit e zhvillimit të qëndrueshëm – përfshijnë prodhimin dhe shpërndarjen e treguesve të BE-së për zhvillim të qëndrueshëm.

Metodologjia e grumbullimit, përpunimit, shpërndarjes dhe analizës së të dhënave

Metodologjia e grumbullimit, përpunimit, shpërndarjes dhe analizës së të dhënave përfshin aktivitetet/fushat e mëposhtme:

- Meta të dhënat dhe klasifikimet
- Konfidencialiteti statistikor dhe mbrojtja nga zbulimi

Meta të dhënat dhe klasifikimet - përfshin temat: meta të dhënat referuese (ESMS) dhe meta të dhënat strukturore (listat e kodeve, etj.) dhe të gjitha llojet e klasifikimeve.

Konfidencialiteti statistikor dhe mbrojtja nga zbulimi - përfshin temat e mbrojtjes së të dhënave.